



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P 21/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	NënKryetar
Vima Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.01.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me skualifikimin e operatorit ekonomik “Guard & Protect Rica” shpk, nga procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF- 36051-09-16-2019, me objekt: “Shërbimi Privat të Sigurisë Fizike të DSHS-Kurbin” - Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 12 muaj”, me fond limit 3,352,000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 25.11.2019, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kurbin.

Ankimues: “Guard & Protect Rica” shpk
Adresa: Lagjia Nr. 1, Pallati 9-katësh, Kati 9, Laç.

Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kurbin.
Adresa: Lagjia Nr. 4, Laç - Kurbin.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e

rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 17.09.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Kërkesë për Propozim*” me Nr. REF- 36051-09-16-2019, me objekt: “*Shërbimi Privat të Sigurisë Fizike të DSHS-Kurbin*” - Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 12 muaj”, me fond limit 3,352,000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 18.11.2019, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kurbin.

II.2. Në datën 18.11.2019 është zhvilluar procedura e prokurimit nga ana e autoritetit kontraktor.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se në datë 25.11.2019, autoriteti kontraktor ka bërë vlerësimin e procedurës së prokurimit, në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

1. "Guard & Protect Rica" shpk	3,160,218.16 lekë	skualifikuar
2. "Nazeri 2000" shpk	2,160,218.16 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 25.11.2019, operatori ekonomik "Guard & Protect Rica" sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyen si mëposhtë:

Në verifikimin e dokumentacionit tuaj rezulton se ka mangësi si më poshtë 1-Në shtojcën nr 4 keni deklaruar se Drejtuesi Teknik është Arjan Pal Skeja ndërsa në QKB dhe në dokumentacionin e dorëzuar është Najet Ahmeti.

2-Performanca me nr 1814 prot e datës 13.09.2019 është fotokopje kjo në kundërshtim me kushtet e vendosura në DST 7 Kriteret e vecanta, Kapaciteti Teknik ku thuhet të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim. Në zbatim të ligjit nr 9643 date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" në fuqi oferta juaj refuzohet për mosplotësim dokumentacioni.

II.4.1. Në datën 03.12.2019, operatori ekonomik "Guard & Protect Rica" shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor ku kundërshton vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e tij nga kjo procedurë prokurimi në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë vijon:

Jemi njohur elektronikisht ne faqen zyrtare ëëë.app.gov.al, me vleresimin e procedures se prokurimit me objekt "Sherbimin Privat te Sigurise Fizike te DSHS-Kurbin" e organizuar nga Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kurbin zhvilluar ne daten 18.11.2019 ora 10.00.

Nga shqyrtimi me kujdes i argumentave te perdorur nga A.K per skualifikimin tone konstatuam se keto te fundit jane ne kundërshtim me rregullat e miratuara te prokurimit publik.

Per arsyen e lartepermendur ne mbeshetje te Ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 63 "Te drejtat e personit te interesuar", dhe neni 56/4 "Llogaritja e afateve" te Kodit Procedures Administrative po ju dergojme kete ankese duke ju parashtruar kundërshtimet tone si vijon:

1. Ne mesazhin e derguar elektronikisht si arsye skualifikimi A.K shprehet:

- Ne verifikimin e dokumentacionit tuaj rezulton se ka mangësi si më poshtë 1- Ne shtojcën nr 4 keni deklaruar se Drejtuesi Teknik është Arian Pal Skeja ndërsa në QKB dhe në dokumentacionin e dorëzuar është Najet Ahmeti. 2- Performanca me nr 1814 prot e datës 13.09.2019 është fotokopje kjo në kundërshtim me kushtet e vendosura në DST 7 Kriteret e vecanta, Kapaciteti Teknik ku thuhet të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti ose të dokumentave të rreme e të

pasakta, konsiderohen si kushte per skualifikim. Ne zbatim te ligjit nr 9643 date 20.11.2006 Per Prokurimin Publik ne fuqi oferta juaj refuzohet per mosplotesim dokumentacioni.

2. Ne lidhje me argumentin e pare per drejtuesin teknik te shoqerise ju sqarojme se persa i perket deklarimit ne shtojcen 4 per shkak te nje lapsusi njerezor kemi vendosur emrin e Z. Arian Pal Skeja. Nderkohe i gjithë dokumentacioni tjetër i dorezuar verteton se shoqeria ka ndryshuar drejtuesin teknik me Z. Najet Lik Ahmeti i cili është drejtuesi teknik i ri i shoqerise te cilin e kemi deklaruar ne te gjitha organet kompetente. Gjithashtu e kemi siguruar dhe kemi respektuar te gjithë dispozitat ligjore. Gjykojme se i gjithë dokumentacioni i dorezuar verteton kete fakt dhe e shohim si te nxituar arsyetimin e KVO-se per te na skualifikuar per shkak te nje lapsusi i cili sado i madh te jete nuk ndryshon te verteten dhe nuk mund te perifrazohet nga ju si nje deklarim i rreme. Jo pa qellim kemi dorezuar te gjithë dokumentat aplikimet apo deklaratat e marrjes ne pune per t'ju vertetuar efektet e ketij ndryshimi ne stafin drejtues te shoqerise. Ne perfundim ju ftojme te respektoni parimet e barazise ndermjet operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit duke mosdiskriminuar dhe operatorët e biznesit te vogel ashtu sic parashikohet ne L.P.P.

- Per sa thame me lart i Autoritetit Kontraktor te korrigjohje shkeljen e KVO-se dhe te kualifikojte shoqerine "Guard & Protect Rica" shpk.

Ne permbledhje te argumentave tona te larpermendura dhe ne mbeshtetejet te Ligjit nr/9643 dt 20.11.2006 "Per prokurimin publik" i ndryshuar kerkojme nga institucioni juaj qe:

- 1. Pezullimin e cdo faze te prokurimit derisa ankesa jone te jete shqyrtuar teresisht.*
- 2. Marrjen parasysh te ankeses tone.*
- 3. Kualifikimin e shoqerise "Guard & Protect Rica" shpk.*

II.4.1. Në datën 10.12.2019, me shkresën nr. 276/3 prot, operatori ekonomik "Guard & Protect Rica" shpk, është vënë në dijeni në lidhje me mospranimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

II.4.2. Në datën 17.12.2019, pala ankimuese operatori ekonomik "Guard & Protect Rica" shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.3. Me shkresën me nr. 276/4 prot, datë 27.12.2019, protokolluar me tonën me nr. 1885/2 prot, datë 30.12.2019, me objekt "Informacion", si dhe shkresës me nr. 287 prot, datë 31.12.2019, protokolluar me tonën me nr. 1885/3 prot, datë 06.01.2020, është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Guard & Protect Rica” sh.p.k. me arsyetimin se: *“Në lidhje me argumentin e parë për drejtuesin teknik të shoqërisë ju sqarojmë se përsa i përket deklarimit në shtojcën 4 për shkak të një lapsusi njerëzor kemi vendosur emrin e Z. Arian Pal Skeja. Ndërkohë i gjithë dokumentacioni tjetër i dorëzuar vërteton se shoqëria ka ndryshuar drejtuesin teknik me Z. Najet Lik Ahmeti i cili është drejtuesi teknik i ri i shoqërisë të cilin e kemi deklaruar në të gjitha organet kompetente. Gjithashtu e kemi siguruar dhe kemi respektuar të gjithë dispozitat ligjore. Gjykojmë se i gjithë dokumentacioni i dorëzuar vërteton këtë fakt dhe e shohim si të nxituar arsyetimin e KVO-së për të na skualifikuar për shkak të një lapsusi i cili sado i madh të jetë nuk ndryshon të vërtetën dhe nuk mund të perifrazohet nga ju si një deklaram i rreme. Jo pa qëllim kemi dorëzuar të gjithë dokumentat aplikimet apo deklaratat e marrjes në punë për t’ju vërtetuar efektet e këtij ndryshimi në stafin drejtues të shoqërisë. Në përfundim ju ftojme të respektoni parimet e barazisë ndërmjet operatorëve ekonomike në procedurat e prokurimit duke mosdiskriminuar dhe operatorët e biznesit të vogël ashtu sic parashikohet në L.P.P.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 “KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT” pika.1 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

“Ofertuesi duhet të deklarojë se:

a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)

b) nuk është dënua për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,

c) nuk është dënua me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4.”.

Gjithashtu në dokumentat e tenderit autoriteti kontraktor ka publikuar Shtojcën 4, si më poshtë:

Shtojca 4

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilesinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.

- Personi/at në cilësinë e **anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik**, si më poshtë:

_____ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP¹.

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

- Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

- Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

III.1.2. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.2 “Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë”, autoriteti kontraktor ka parashikuar si më poshtë vijon:

Liçensën e Titullarit dhe të Drejtuesit Teknik lëshuar konform akteve normative në fuqi, Ligjit 75/2014 për SHPSF nënkategoria 1.3 A.

III.1.3. Për përmbushjen e këtij kriteri kualifikues ofertuesi “Guard & Protect Rica” shpk ka dorëzuar në SPE dokumentacionin si më poshtë:

– Shtojcën 4.

– Ekstraktin e Rregjistrimit Tregtar datë 16.11.2019 dhe Ekstraktin Historik datë 16.11.2019.

III.1.4. Në Ligjin nr. 103/2018 për disa ndryshime në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar”, në nenin 1 është vendosur: “Në nenin 45 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë: “1. Autoriteti kontraktor skualifikon nga procedura e përzgjedhjes së fituesve të kontratave publike çdo operator ekonomik, nëse është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për ndonjë nga veprat penale të mëposhtme:

a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste;

b) korrupsion;

c) mashtrim;

ç) pastrim parash ose financim i terrorizmit;

d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste;

dh) organizim, drejtim ose financim i veprimtarisë së prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, si dhe i veprimtarisë së trafikimit të narkotikëve;

e) falsifikim;

ë) shfrytëzim i punës së të miturve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.

Detyrimi për të skualifikuar një operator ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operator ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.”.

2. Paragrafi i parë i pikës 3 ndryshohet si më poshtë:

“Me qëllim plotësimin e kushteve të parashikuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

a) vërtetim mbi gjendjen gjyqësore ose një dokument, të lëshuar nga një autoritet kompetent, që vërteton kushtet e parashikuara në pikat 1 dhe 2, shkronjat “a”, “b” dhe “c”. 3. Kudo ku përmenden, në titull dhe në përmbajtjen e këtij neni, fjalët “kandidatë ose ofertues” zëvendësohen me fjalët “operator ekonomik”.

III.1.5. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.

III.1.6. Në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit....”.

III.1.7. Nga shqyrtimi i ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Guard & Protect Rica” sh.p.k rezulton se është paraqitur deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, ku ndër të tjera deklarohet se: “... operatori ekonomik “Guard & Protect Rica” sh.p.k nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në nenin 45/1 të LPP-së..”

Gjithashtu është deklaruar se “personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

1. Znj I. Rica në cilësinë e Titullares të Subjektit dhe ortakut të vetëm të shoqërisë, Z. A. Skeja në cilësinë e Drejtuesit Teknik të Subjektit, kanë kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brënda operatorit ekonomik “Guard & Protect Rica” shpk, nuk janë ose kanë qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP.”

Nga verifikimi i ekstraktit të subjektit “Guard & Protect Rica” sh.p.k, rezulton se:

- 1. I. R në cilësinë e Administratores së shoqërisë.*
- 2. I. R në cilësinë e Ortakes të vetme të shoqërisë.*
- 3. N. A në cilësinë e Drejtuesit Teknik të shoqërisë kategoria 1.3.A.*

III.1.8. Operatorët ekonomikë kanë detyrimin ligjor të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Pra autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat

dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar.

III.1.9. Në rastin konkret, nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Guard & Protect Rica” sh.p.k, konkretisht Ekstraktit Historik të Rregjistrimit Tregtar rezulton se ky operator ekonomik ka si drejtues teknik z. N. A, ndërsa referuar shtojcës 4 deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të ngarkuar në SPE rezulton se në vetdeklaratën me shkrim të depozituar nga ky operator ekonomik është pasqyruar si drejtuesi teknik z. A. S, i cili nuk figuron si drejtues teknik në Ekstraktin Historik të Rregjistrimit Tregtar. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se shoqëria “Guard & Protect Rica” sh.p.k ndodhet në kushtet e parashikuara në nënin 45, pika 1 të LPP-së pasi drejtuesi teknik është individ me detyra kontrolluese brenda subjektit, dhe ka funksione brenda shoqërisë, ndaj dhe është detyrim ligjor për subjektin që në vetdeklaratën me shkrim mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të deklarojë të gjithë “personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik në përputhje me nënin 45/1 të LPP i ndryshuar.

Pra operatorët ekonomikë kanë detyrim ligjor, në përputhje me nënin 45 të LPP-së, të deklarojnë në procedurat e prokurimit drejtuesit teknik, në kushtet kur këta janë në përbërje të shoqërisë në kuptim të organeve drejtuese / kontrolluese / vendimarrëse të shoqërisë.

Përsa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Guard & Protect Rica” shpk nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet mbi arsyet e tjera të skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Guard & Protect Rica” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, referuar gjykimin mësipër në pikën III.1.9., gjykon se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi, gjendja faktike dhe juridike e këtij operatori ekonomik do të vijojë të ngelet e skualifikuar edhe pas ankimit në KPP, duke mos pasur më interes të ligjshëm në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Guard & Protect Rica” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF- 36051-09-16-2019, me objekt: “Shërbimi Privat të Sigurisë Fizike të DSHS-Kurbin” - Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 12 muaj”, me fond limit 3,352,000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 25.11.2019, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kurbin.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1885 Protokolli, Datë 17.12.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

NënKryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha